

AKT- THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“Permakinat.al” shpk

Ne Durres, sot me date 26 Shtator 2022

Ortaku i vetem themelues:

Z.Aldo Sulaj, i datelindjes 27/01/1991, lindur ne Berat dhe banues ne Durres, shtetas shqipetar madhor, me zotesi juridike për të vepruar identifikuar me karte identiteti me numer J10127083V, me cilesine e “Ortakut themelues” kerkoi redaktimin e ketij akti themelimi, nepermjet te cilit deklaroi se me vullnet te lire te plote e te sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “Per tregetaret dhe shoqerite tregetare”, ligjin nr.9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, ne ate Doganor, Fiskale Tatimor, krijon shoqerine tregetare, me pergjegjesi te kufizuar, “Permakinat.al” shpk

KREU I

Neni 1

Krijimi

“Permakinat.al” shpk

Eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne QKB, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj Shoqeria “**Permakinat.al**” shpk, eshte nje shoqeri tregetare, e themeluar nga shtetasi shqipetar **Z.Aldo Sulaj**, i cili pergjigjet per detyrimet e shoqerise tregetare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara. Kontributi i ortakut perben kapitalin e regjistruar te shoqerise.

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka seline në Lagjia Nr.14, Ura e Dajlanit Truall me Nr Pasurie 163/69 ZK2574. Shoqëria mund të ndryshoje seline e saj , te hapë zyra përfaqësie, degë, të krijoj filiale, si brenda dhe jashtë vendit Republikës së Shqipërisë , vetëm me vendimin e Ortakut themelues .

Neni 4

Objekti i veprimtarise

Import Eksport .Tregeti me pakice e pjeseve te kembimit, makina me qera dhe shitblerje automjetesh

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

KREU II

Kapitali

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njqind mije) leke, i ndare ne 1 kuote me vlere nominale 100.000 (njqind mije) leke, i nenshkruar plotesisht nga ortaku vetem themelues ne masen 100%. Pjeset e kapitalit themeltar nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlere te tregetueshme. Kontributi i ortakut mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme te paluajtshme apo te drejta). Ortaku i vetem pergjigjet per humbjet e shoqërisë perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te kapitalit themeltar te shoqërisë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuota e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e fiton ate pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes, nga çasti i kalimit te kuotave, deri ne çastin e regjistrimit te kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 te ligjit nr.9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”.Regjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ.Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Ortaku i vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise.Ortaku i vetem eshte organi vendimmarres i shoqrise qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Çdo ndryshim statute duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Ortaku vendos per çeshtje si :

- a) Percaktimi i politikave tregetare te shoqerise
- b) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- c) Emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar
- d) Percaktimin e shperblimeve

- e) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregëtare nga administratoret, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) Përfaqesimin e shoqërisë në gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- g) Miratimin e rregullave procedural të mbledhjeve të asamblese;

Te gjitha vendimet e marra nga ortakët vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për :

- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) Investime;
- d) Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e përgjithshme të regjistrit të vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundërshtojë pavlefshmerinë e tyre, që ka fituar të drejtë në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmerinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9

Administrimi

Administratori i shoqërisë "Permakinat.al" shpk, caktohet **Z.Aldo Sulaj**, i cili emërohet për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripëritjetje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Ortakut të vetëm themelues të shoqërisë.

Neni 10

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të :

- a) Kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregëtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregëtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) Përfaqesojë shoqërinë tregëtare;
- c) Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabel të shoqërisë;
- d) Përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve i paraqesin këto dokumenta përpara asamblese së përgjithshme për miratim;
- e) Krijoi një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë.

- f) Kryej regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqrise sic parashikohet ne ligjin per QKR.
- g) Raportoi perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare.

Administratori eshte i detyruar te therrase ne mbledhjen e asamblese ne rastet kur :

Sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te asetave te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Administratoret, se bashku edhe vecas njeri tjetrit, kane te drejte te kryejne te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te jashtzakonshem. Administratoret e perfaqesojne Shqiperine perpara te gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo te huaj, autoriteteve shteterore shqiptare apo te huaja, perfshi ketu autoritetet gjyqesore te gjitha shkalleve. Administratoret kane te gjitha kompetencat per te vepruar ne mardhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ja jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratoret angazhojne shoqerine ne mardhheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj. Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administratorit e kalonte objektin e shoqerise ose per te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk esht prove e mjaftueshme.

Neni 11

Viti Financiar

Viti Financiar i shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon ne 31 dhjetor. Perjashtimisht, viti i parefinanciar fillon nga data e regjistrimit te shkoqerisë ne QKR dhe mbyllet ne 31 dhjetor.

Neni 12

Shperndarja ose prishja e shoqeris mund te behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj
- b) me vendim te ortakve themelues
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit

- d) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe nuk esht njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 “Per Qendren Kombtare te Regjistrimit”
- e) me vendim te gjykates

Ne kete rast Asamblea merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te shoqeris, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo document te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ shoqeri ne likuidim e siper”.

Neni 13

Baza ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjiit “Per tregtaret dhe shoqerit tregtare”, Kodit Civil dhe cfar do ligji tjeter specific ne Republiken e Shqiperis

Neni 14

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare ne gjuhen shqipe, me permbajtje dhe vlera te njejta juridike.

Akti i mesiperm pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i shoqerise tregtare Shpk, nenshkruhet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij origjinale .

ORTAKU I VETEM THEMELUES

SHTETASI SHQIPETAR

ALDO SULAJ